REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC
Nr. Br. No. 01-060/01-37027/26
Nr. i fq. / Br.str. / No.pg.
Data / Datum / Date 18.11.2026
OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić–Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal të mbajtur me dt.29.10.2026, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit Komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Albanë Shillova Shalaku (LVV), Arbenita Pllana (LVV), Bardhyl Mjekiqi (LVV), Burim Ismaili (LVV), Fitim Grajçevci (LVV), Fjolla Nasufi (LVV), Lendita Krasniqi (LVV), Mervete Shala (LVV), Sami Ahmeti (LVV), Abdyrrahman Krasniqi (LDK), Bajram Hashani (LDK), Fidan Ahmeti (LDK), Fitore Hashani (LDK), Vlora Mjekiqi Kabashi (LDK), Enver Gashi (LDK), Labinot Mirena (LDK), Linda Bekteshi (LDK), Muhamet Preniqi (LDK), Biljana Spasic (SL), Goran Dancetovic (SL) dhe Dorentina Mustafa (AAK).

Të pranishmit tjerë: Kryetari i Komunës, Halil Thaçi, Nënkryetari i Komunës Berat Gashi, drejtorët komunal dhe të tjerë

Mbledhjen e udhëhoqi Sami Ahmeti, kryesues i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi i mungesave
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar e mbajtur me dt.30.09.2026
3. Shqyrtimi i Raportit finaciar të shpenzimeve për periudhën janar-shtator 2026, të paraqitur nga drejtori i DEFZH-së, me nr.04-052-01-32787-26, dt.14.10.2026
4. Shqyrtimi i kërkesës për rritjen-tejkalimin e të hyrave vetanake të vitit 2026 të paraqitur nga drejtori i DEFDZH-së, me nr.04-400/01-33192/26, të dt.16.10.2026
5. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës me nr.02-020-01-32774-26, të dt.14.10.2026 për raportin në lidhje me Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi
6. Shqyrtimi i kërkesës së drejtoreshës të Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) me nr.10-104-02-28241-26, të dt.11.09.2026 për regjistrimin e pronës shoqërore Shkolla Fillore "Vëllaznimi" në emër të Komunës së Obiliqit
7. Shqyrtimi i kërkesës së drejtoreshës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) me nr.14-104/02-30532/26, dt.30.09.2026 për regjistrimin e pronës shoqërore Shkolla Fillore -Milloshevë në emër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport-Komuna e Obiliqit
8. Shqyrtimi i kërkesës së drejtoreshës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) me nr.14-104/02-33246/26, dt.19.10.2026 për bartjen e pronës së Shtëpisë së Kulturës në Plemetin në emër të Komunës së Obiliqit
9. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës me nr.02-020-01-31469-26, të dt.06.10.2026 për vendosjen në debat publik të Draft-Planit Komunal për Integritet për periudhën 2027-2030
10. Shqyrtimi i Projekt-Propozimit të drejtorit të DPUKP-së, me nr.05-463/06-33311/26, dt.19.10.2026 për fillimin e procedurave për hartimin e Planit rregullues të hollësishëm
11. Të ndryshme

Kryesuesi – Para se t'i njoftoj të pranishmit me rendin e ditës, fjalën ia dha znj.Albanë Shillova Shalaku.
Albanë Shillova Shalaku – Duke u bazuar në shqetësimet e ngritura në njërën nga mbledhjet e Kuvendit nga drejtori i DPUKP-së, z. Gazmend Krasniqi, lidhur me mospërputhjet e evidentuara ndërmjet listës së mëparshme të pronave komunale të dhëna në shfrytëzim dhe listës së përpiluar nga zyrtarët aktual komunal, ne si grup kërkojmë që kjo çështje të trajtohet si pikë e fundit
e rendit të ditës. Konsiderojmë se është obligimi ynë institucional të sigurohemi që pronat komunale të administrohen në mënyrë të ligjshme, transparente dhe në përputhje me destinimin për të cilin janë dhënë në shfrytëzim. Për këtë arsye, propozojmë që Kuvendi të shqyrtoj mundësinë e themelimit të një Komisioni të përbërë nga përfaqësuesit e të gjitha subjekteve politike të përfaqësuuara në Kuvend, për të mbikqyrë procesin e verifikimit të pronave komunale, për të shqyrtuar dokumentacionin përkatës dhe për të evidentuar nëse, pronat janë duke u shfrytëzuar sipas kushteve dhe destinimit të përcaktuar. Theksoj se kjo nismë nuk ka për qëllim paragjykimin ose akuzimin e askujt, por sqarimin e plotë të gjendjes, mbrojtjen e interesit publik dhe garantimin e transparencës në menagjimin e pasurisë sonë.
Kryesuesi – Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ të MAPL-së, nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, neni 57 të LVL-së, anëtarët e Kuvendit kanë mundësi të kërkojnë pikë shtesë para fillimit dhe para votimit të rendit të ditës. Kështu që fillimisht votojmë nëse, jemi për me përfshi këtë pikë në rend dite, pastaj votojmë për rendin e ditës si tërësi.
Anëtarët e Kuvendit me 13 vota për, dhe 8 vota abstenim, votuan që si pikë e 11 e rendit të ditës të jetë formimi i Komisionit ad hoc për verifikimin dhe mbikqyrjen e dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës së Obiliqit dhe menaxhimi i tyre në të kaluarën..
Kryesuesi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës si tërësi i cili u miratua me 15 vota për, dhe 6 vota abstenim, me përfshirjen e pikës së 11 në rend dite të cekur më lartë.
Pika 1 e rendit të ditës
Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.
Pika 2 e rendit të ditës
Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 18 vota për, dhe 3 vota abstenim.
Pika 3 e rendit të ditës
Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e Raportit finaciar të shpenzimeve për periudhën janar-shtator 2026, të paraqitur nga drejtori i DEFZH-së.
Fjolla Nasufi – Raportin e kemi pranuar dhe e mbështesim këtë raport sepse transparenca dhe llogaridhënia për shpenzimin e parasë publike janë thelbësore. Pra, është e rëndësishme që shpenzimet të jenë në funksion dhe interes të qytetarëve.
Fitore Hashani – Në radhë të parë ne e morëm raportin financiar, por në specifikacione sikurse që është cekë tabelat te Drejtoritë ose te subvencionet të theksuara, një gjë e tillë mungon te buxheti, ose te projektet e realizuara, ose në realizim. Kjo, do të thotë se nuk janë të specifikuara në tabelë në mënyrë specifike ashtu siç i kemi paraqitë gjithmonë edhe siç obligon Ligji i financave, investimet kapitale, gjë që na bën të hamendësojmë se ku është procedura e këtyre projekteve dhe çfarë ka ndodhë me këto. Megjithatë, në tabelat e përmbledhura në të gjitha kategoritë buxhetore, vetëm se jam munduar ti specifikoj dhe shohë që ka disa pamundësi për me i sqaru se ku ka mbetë procedura e këtyre projekteve, po ashtu, edhe te pjesa e kodeve buxhetore, alokimet shohim mangësi në disa projekte. E shohë se buxheti në total është i realizuar 82 % por më bën përshtypje se si është realizuar kjo përqindje e buxhetit, do të thotë a janë në rregullë pasqyrat financiare apo ka konteste të këtyre pasqyrave, gjë që më bën të dyshoj duke e parë raportin e vendimeve gjygjësore përmbarimore në të 3 kategoritë, që në total e kalon vlerën 700,000 €. Do të doja nga drejtori një sqarim rreth këtyre pikëpyetjeve të mia, që në pikën e radhës te të hyrat vetanake dhe shpërndarja e tyre, të dijmë se çfarë konkretisht duhet të votojmë apo jo.
Besnik Krasniqi – Sa i përket projekteve që i përmende, ne e dimë shumë mirë se e kemi bërë njëfarë kërkese për rialokim të mjeteve, në Ministrinë e financave. Ajo kërkesë është realizuar dhe ato mjete janë ndarë te mallrat dhe shërbimet dhe një pjesë e këtyre projekteve kapitale dikund 760,000 €, janë derdhë mjetet te subvencionet dhe te mallrat dhe shërbimet. Projektet kapitale janë shkrirë, është bërë rialokimi i

mjeteve dhe ato projekte tash më nuk realizohen sepse kanë kaluar. Përqindja është deri në 20 % përmes rishikimit.

Fjolla Nasufi – Ndoshta pak vonesë po ndërhyj, por, në nderim të znj.Arlinda Zekaj kisha dashur të mbajmë një minutë heshtje.

Kryesuesi – I ftoi të pranishmit për një minutë heshtje në shenjë nderimi për vrasjen e znj.Arlinda Zekaj dhe të pranishmit mbajtën një minutë heshtje.

Kryetari – Ne e kemi trashëguar një buxhet i cili ka qenë buxhet elektoral, dihet shumë mirë. Pra, alokimi i mjeteve që e tha drejtori me shumë vend ka ndodhë për arsye se është projektuar një buxhet shumë elektoral për shembull janë ndarë 30,000 ose 40,000 €, për rr:''Plemetin-Siboc" e që rruga në fakt po kushton 2.1 milionë €. Pra, ka qenë një buxhet komplet elektoral, kanë krijuar kode buxhetore që në fakt vetëm në vitin 2029 janë planifikuar të punohen ato punime. Strategjia jonë, politika jonë është krejtë ndryshe, sepse ne duam të punojmë në kontinuitet dhe nuk duam të punojmë vetëm në vitin e fundit të zgjedhjeve. Për këtë arsye ne e kemi bërë alokimin e mjeteve, kemi filluar projekte të reja dhe jemi duke vazhduar me projekte të reja.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së DEFZH-së, për rritjen-tejkalimin e të hyrave vetanake të vitit 2026.

Fjolla Nasufi – E falenderoj drejtorin për punën e mirë që është duke e bërë dhe e përkrahim çdo mundësi për rritjen e të hyrave vetanake sepse sa më shumë të hyra të ketë Komuna, aq më shumë mundësi do të kemi për investime si dhe përmirësimin dhe shërbimin e qytetarëve.

Fitore Hashani – Kryesues, veç e parashtrova para kësaj kërkese dhe shohë që të gjitha këto tejkalime të të hyrave janë dedikuar në kategorinë mallra dhe shërbime, që nënkupton në 4 Drejtori aktuale. Mirëpo, nuk janë specifikuar saktë çka duhet të jenë këto mallra dhe shërbime, derisa e potencova se tabela buxhetore paraprake na thotë që në disa projekte ka mangësi të fondeve. Këto projekte uroj që do të realizohen në të ardhmen, se në këtë vit po shihet se nuk do të realizohen, por së paku këto mallra dhe shërbime të shkojnë në këto drejtori, në linjat adekuate, aty ku parashihen dhe aty ku ka pagesa ose borxhe të natyrave të ndryshme. Përndryshe, nuk kam sqarim se çka do të ndodhë me këto mjete, ose në cilat vija të këtyre drejtorive do të dedikohen, ose çka janë këto obligime që na detyrojnë t'i paraqesim. Shkresat si zakonisht janë shumë të mangëta.

Kryesuesi – Pra, kjo kërkesë për rritjen e të hyrave vetanake në vlerën prej 350,000 €, është paraqitë edhe për qëllim të shpërndarjes së tyre. Kjo e konfirmon se Komuna ka arritë të mbledhë më shumë të hyra vetanake se që ka qenë e planifikuar fillimisht dhe tani këto mjete shtesë po kanalizohen në mënyrë produktive përmes buxhetit, e që mundësojnë investime të dretëpërdrejta në sektorët jetik, siç janë infrastruktura rrugore publike, arsimi dhe administrata duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e shërbimeve për qytetarët. Ky menaxhim efektiv i buxhetit dëshmon rritje të performancës financiare dhe përkushtim për zhvillimin e mëtutjeshëm të Komunës.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit të Komunës, me 16 vota për, dhe 2 vota abstenim morën Vendim për tejkalimin e të hyrave vetanake të planifikuara për vitin 2026.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës për raportin në lidhje me Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi

Kryetari – Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është formuar nga data 01.04.2026 sipas Udhëzimit administrativ nr.27/2012 MPB nr.03-2012/MAPL për KKSB, neni 9 pika 1.8 obligon kryesuesin e KKSB-së, të informoj Kuvendin Komunal për aktivitetet e zhvilluara. Andaj, deri më sot janë mbajtë 3 mbledhje të KKSB-së, dhe gjatë këtyre takimeve janë diskutuar problemet me të cilat po përballet Komuna e Obiliqit. Mirëpo, është raportuar se është një situatë e sigurisë e cila konsiderohet të jetë e qetë dhe e sigurtë. Gjatë kësaj periudhe nuk janë shenuar raste të natyrës së rëndë, apo me karaktere ndëretnike si dhe nuk është evidentuar ndonjë tentativë që do ta cënonte sigurinë territoriale të Komunës, apo rrezikimin e aseteve me vlerë kombëtare, të cilat janë në zonën tonë të përgjegjësisë. Ndër problemet apo sfidat me të

cilat po përballet Komuna e Obiliqit janë qentë endacakë, trotinetët në rrugë dhe në trotuar, parkingjet e parregullta, mungesa për parkingje për persona me aftësi të kufizuar, aksidentet në komunikacion, vjedhjet, vjedhjet e rënda, dhuna në familje, posedimi ilegal i armëve, posedimi i substancave narkotike dhe dhuna në shkolla. Për këto probleme jemi zotuar që përmes bashkëpunimit ndërinstitucional, por edhe me qytetarët të gjejmë zgjidhjet afatgjate. Për shembull për qentë endacakë kemi lidhë një kontratë e cila na siguron neve, zënien apo kapjen e qenve endacakë dhe vlerësimin e gjendjes shëndetësore, trajtimin, kontrollimin, vaksionimin, identifikimin e qenve endacakë, sterilizimin, hospitalizimin e tyre dhe lëshimin e tyre. Te parkingjet e parregullta në bashkëpunim me policinë apo me drejtorinë përkatëse, do të mundohemi të bëjmë eliminim e kësaj dukurie negative që fatkeqësisht nuk është vetëm në Komunën tonë, por në gjithë Kosovën. Sa i përket veprave penale, këto 2 vitet e fundit nuk kemi pasë as edhe një rast të rëndë. Te vjedhjet e rënda nga 4 vjedhje janë zbuluar 3 që do të thotë se kemi një ulje të veprave penale dhe numri i aksidenteve në komunikacion është i barabartë me vitin e kaluar. Mirëpo, kemi rritjen e gjobave në komunikacion dhe këtë po mundohemi ta përmirësojmë sepse edhe pse Komuna merrë taksa prej këtyre gjobave, ne nuk jemi për pasurimin e Komunës, në xhep të qytetarëve tonë. Rastet e dhunës në familje janë në ulje. Në mbledhjen e 3 të KKSB-së, e kemi pasë si mysafir zëvendësministrin e parë të MPB z.Enver Dugollin, i cili përgëzoi stacionin dhe Komunën tonë e cila është në gatishmëri për asistimin e stacionit policor. Po ashtu, gjendja në shkollat tona është me një siguri më të theksuar ku ka pasë edhe raste të uljes së dhunës dhe të rasteve me narkotik. Në këtë takim unë përmenda se e kemi për qëllim ta kemi edhe një njësi zjarrfikëse duke kërkuar nga MPB-ja, të na ndihmoj, që të na lejoj hapësirën territoriale dhe të kemi planin e reagimit emergjentë. Këshilli lokal për siguri publike ka mbajtë 9 mbledhje dhe ka raportuar se çdo gjë është në rregullë.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së drejtoreshës të Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) për regjistrimin e pronës shoqërore Shkolla Fillore "Vëllaznimi" në emër të Komunës së Obiliqit.

Fjolla Nasufi – Ne si grup e mbështesim këtë kërkesë sepse është e rëndësishme që prona publike ta ketë statusin e rregulluar dhe të jenë të regjistruara sipas procedurave ligjore.

Goran Dančetović – Mua më intereson nëse ligji na lejon neve si asamblistë t'ia kalojmë pronën e dikujt Komunës, dhe nëse ligji e lejon, cili është ai ligj dhe cili është numri i nenit të ligjit. Mendoj se ndoshta duhet të mbahet një dëgjim publik me banorët që jetojnë në rrethinën e atij oborri shkolle.

Gazmend Krasniqi – Sa i përket kësaj në Komunën e Obiliqit, ka shumë prona që menaxhohen nga Komuna e Obiliqit, ndërsa nuk e kanë titullarin Komuna e Obiliqit. Kjo, po na bën që krejtë projektet tona duhet ti nisim ose paleje, ose duhet me rregullue çështjen e pronësisë fillimisht në mënyrë që të procedohen për projektet e ardhshme. Këto, janë disa prona në qytet të Obiliqit, në disa hapësira që duhen me qenë në emër të Komunës së Obiliqit, pasi që menaxhohen edhe tash nga Komuna e Obiliqit. Sa për ilustrim më konkret edhe materialin e keni pranuar që këto prona të cilat aktualisht vazhdojnë të evidentohen në kadastër në emër të një institucioni arsimor i cili nuk ekziston më është e domosdoshme që Kuvendi Komunal të merrë vendim që këto prona të regjistrohen apo të barten në kadastër në emër të Komunës së Obiliqit. Pas konfirmimit ligjor të këtij vendimi i njejti sipas ligjit nr.08/L-237 për kadastër të pronës së paluajtshme të merrë formën e titullarit juridik mbi bazën e të cilit do të bëhen ndryshimet e nevojshme në kadastër në favor të Komunës së Obiliqit.

Kryesuesi – Këtu nuk bëhet fjalë për prona private, bëhet fjalë për prona shoqërore dhe pronat shoqërore janë të shtetit të cilat shteti i orienton ashtu, siç ka nevojë dhe ashtu siç i duhen për investimet e tyre.

Abdyrrahman Krasniqi – Kryesues kërkesa ime ka qenë edhe në KPF dhe ndoshta kishte me qenë mirë drejtor me formu një Komision sepse ne e dimë se Komuna, është në zhvillim e sipër siç thatë edhe ju se ka shumë prona dhe për të gjitha pronat mos të shkojmë ne proceduralisht në çdo mbledhje të Kuvendit. Mirëpo, pronat mund të evidentohen dhe të shikohet mundësia të kthehen në titullar të Komunës tonë sepse ne e dijmë se shkollat ose oborret ku janë shkollat e ndërtuara janë të gjitha në pronësi të Komunës.

Projektet kapitale të cilat janë ndërtuar ndër vite në Komunën e Obiliqit, pothuajse 70 % nuk janë të regjistruara si asete komunale, ndoshta edhe për këtë kishte me qenë mirë të shikohej nga drejtori dhe të

formohej një komision, siç e parashehë ligji. Ne në këtë mënyrë edhe ua rritim vlerën duke filluar prej asfaltimeve. sallat sportive, parqet, do të thotë të gjitha këto mundemi me i bartë si asete komunale.
Gazmend Krasniqi – Pikërisht, ky është qëllimi pse e kemi nisë këtë procedurë do të thotë auditori ka gjetë shkelje se objektet e Komunës, janë të ndërtuara paleje. Pikërisht, kjo shkollë ka një parcelë qysh është Shtëpia e Kulturës, që gjysma e Shtëpisë së Kulturës figuron parcelë e shkollës fillore "Vëllaznimi". Prandaj, duke u bazuar në këtë për me i shpejtuar procedurat dhe me i rregullue këto çështje. Ne i kemi bërë 2,3 kërkesa në këtë seancë të Kuvendit përndryshe, në mbledhjet e ardhshme do ta bëjmë taman listën qysh e kërkove edhe ti që të gjenden krejtë këto, prona publike që menaxhohen prej Komunës, të votohen dhe të i'u ndërrohet titullari në Komunën e Obiliqit.
Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit të Komunës, me 19 vota për, dhe 2 vota abstenim morën Vendim për Miratimin e kërkesës për regjistrimin në emër të Komunës së Obiliqit, në kadastër të njësive kadastrale (parcelave) të cilat aktualisht figurojnë të regjistruara në emër të P.SH.Shfrytëzues SH.F."Vëllaznimi".
Pika 7 e rendit të ditës
Kryesuesi - Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së drejtoreshës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) për regjistrimin e pronës shoqërore Shkolla Fillore'' Milloshevë'', në emër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport-Komuna e Obiliqit
Fjolla Nasufi – Edhe kjo pikë është si pika paraprake e natyrës së njejtë dhe ne e mbështesim.
Anëtarët e Kuvendit të Komunës, me 19 vota për, dhe 2 vota abstenim morën Vendim për Miratimin e kërkesës për regjistrimin në emër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Obiliqit, në kadastër, të njësisë kadastrale (parcelës) e cila aktualisht figuron e regjistruar në emër të P.SH.SHKOLLA FILLORE'' MILLOSHEVË''.
Pika 8 e rendit të ditës
Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së drejtoreshës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) për bartjen e pronës së Shtëpisë së Kulturës në Plemetin në emër të Komunës së Obiliqit.
Enver Gashi – Ne vetëm sa e bëmë një bartje prej shkollës në Drejtori të Kulturës dhe tash, nuk po ia bartim Drejtorisë së kulturës por Komunës, pse nuk po shkon drejtëpërdrejtë në Drejtori të kulturës me u bartë kjo pronë.
Kryesuesi – Te pyetja e parë kishte të bëjë me një investim direkt që kërkohet prej Ministrisë së sportit, Ndërsa, te ky rast kur është në emër të Komunës, mund të kthehet në secilën Drejtori, por sido që të jetë Kryetari mund ta merrë fjalën.
Kryetari – Është pyetje me vend dhe këtu, vërtetë kur e shehë duket se është një lloj manevrimi herë në Komunë e herë në Drejtori të kulturës, por çështja është se kemi investimin në stadiumin në Milloshevë 1.7 milionë €, që është buxhetuar një investim i tillë dhe neve po na duhet për çështje procedurale për derisa stadiumi do të menaxhohet nga Drejtoria e kulturës, me procedurat e Ministrisë, kjo pronë duhet ti kaloj Drejtorisë së kulturës. Kjo është poenta dhe nuk ka kurgjë tjetër këtu, por e vetmja është se 1.7 milionë €, do të investohen në stadiumin e Milloshevës.
Goran Dančetović – Pyetje për drejtorin e urbanizmit – kush është pronari aktual i parcelës në të cilën ndodhet Shtëpia e Kulturës në Plemetin.
Gazmend Krasniqi – Pasi që është pronë shoqërore atëherë pronari është Komuna e Obiliqit, dhe ne duhet thjeshtë te ndërrojmë titullarin, e jo të ketë titullar ose si shumë prona shoqërore që kanë qenë paralufte, por të bëjmë update edhe në sistemin tonë legjislativ që e kemi tash. Mirëpo pronar i Shtëpisë së Kulturës në Plemetin është Komuna e Obiliqit, dhe e menaxhon.
Kryetari – Është pronë shoqërore, pak me thjeshtu këtë çështje. Ne e dimë shumë mirë se ajo dje, tash dhe për 26 vite është keqpërdorë, nuk është përdorë por është keqpërdorë. Z. Dancetovic, e din shumë mirë se aty janë mbajtë dasmat, takimet ilegale, ka pasë zyre ilegale dhe persona ilegal kanë funksionue aty, kështu që ai objekt i është kthye menaxhimit të Komunës dhe aty punëtorët tonë po punojnë. Natyrisht që përveç që punëtorët tonë tashmë punojnë aty, ka aktivitete, organizohen aktivitete, por gjithmonë duke i organizuar institucioni i Komunës. Tashmë, kemi ardhë në pikën ku kjo pronë nga prona shoqërore duhet ti

kaloj Komunës së Obiliqit, prandaj të dashur asambleistë e keni rastin historik sot që pas 26 viteve, një pronë e keqpërdorur nga persona të paautorizuar ti kthehet titullarit të vet Komunës së Obiliqit. Unë ju falenderoj shumë për mbështetjen e vazhdueshme që po i votoni këto kërkesa tona që ne po i kemi si Ekzekutiv.

Goran Dančetović – Sa e kuptova, përgjigja e drejtorit nuk është „pronën komunale në Plemetin po ia japim përsëri Komunës. Mendoj se ka dallim midis shfrytëzuesit dhe pronarit, sepse shfrytëzuesi është dikush që diçka po e shfrytëzon aktualisht, ndërsa pronari është dikush që ka pronësi të përhershme mbi ndonjë parcelë. Pjesa e dytë – pasi kryetari shpjegoi destinimin e ndërtesës, unë duhet të kthehem shumë vite pas: kjo ndërtesë nuk është financuar nga Komuna e Obiliqit, kjo ndërtesë është financuar nga një organizatë joqeveritare për rininë në Plemetin, dhe nëse ktheheni në arkivën tuaj, do të shihni cili është destinacioni themelor i atij objekti. Pajtohem se duhet t'i vihet në shërbim destinacionit të rinisë së Plemetinit dhe të vihet në atë funksion. Tani për tani mendoj se nuk është në atë funksion.

Kryetari – Pikërisht ky objekt mendimin që ti e ke për me iu kthye rinisë atë edhe po e bëjmë me iu kthye rinisë së Obiliqit, rinisë së Plemetinit, e jo me i keqpërdorë strukturat paralele prej Serbisë me ardhë aty. Kjo ka qenë pronë shoqërore dhe po kthehet në pronë komunale, po ta japë përgjigjen edhe të drejtorit të Urbanizmit. Do të shfrytëzohet nga qytetarët e Komunës së Obiliqit, që do ti dimë me emër e mbiemër dhe aty më nuk do të hyjnë struktura paralele të ardhura nga Serbia dhe nuk do të keqpërdoret më, mjaftueshëm është keqpërdorë.

Goran Dančetović – Duhet t'ju them, kryetar [ose kryetare], se sindikatat e punëtorëve të energjisë elektrike i kanë shfrytëzuar ato zyra në bazë të dokumenteve që janë lëshuar nga ky institucion; ish-kryetari i Komunës – ia kam harruar mbiemrin, si quhej – u kishte dhënë atyre disa zyra në shfrytëzim. Ju e keni shfrytëzuar këtë, keni bërë prej kësaj lëvizje marketingu – mbylljen e disa zyrave – kurse vetëm është dashur të anulonit vendimin që e ka dhënë ndonjë nga paraardhësit tuaj dhe të lëshonit një vendim se nuk mund t'i shfrytëzojnë më ato zyra.

Kryetari – Nëse, ti thua se elektroekonomia e Serbisë i duhen zyre aty, e ka përdorë zyren është e vërtetë nëse, kanë bërë marketing në emër të elektroekonomisë janë ata individë që ti i njehë më mire se unë. Unë nuk dua të merrem me vendimet apo me punën që e kanë bërë Kryetarët e mëhershëm, ata i dinë punët e veta dhe unë i di punët e mia. Ata persona që janë aty, duhet me ditë kush janë dhe nuk mund me thënë elektroekonomia e Serbisë me funksionue në Plemetin, nuk ka mundësi. Dita e fundit kur ka funksionuar elektroekonomia e Serbisë në Kosovë është 12 qershori i vitit 1999, tash është Korporata Energjetike e Kosovës, ka qenë Korporata Elektroenergjetike në vitin 2012 pas privatizimit të distribucionit tash është vetëm Korporata Energjetike e Kosovës.

Kryesuesi – Republika e Kosovës ka institucione shumë funksionale dhe kushdo që ka ndonjë vërejtje mund të ankohet në institucionet e Republikës së Kosovës, ndërsa për të tjerat ky Kuvend ka edhe autoritet dhe autonomi të plotë me marrë vendime në lidhje me pronat shoqërore, që ekzistojnë në territorin e Komunës së Obiliqit.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit të Komunës me 18 vota për dhe 2 vota kundër morën Vendim për Miratimin e kërkesës për regjistrimin në emër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Obiliqit, në kadastër të njësisë kadastrale (parcelës) e cila aktualisht figuron e regjistruar në emër të P.SH. SHFRYTEZ.FSH.PLEMETIN D.S.KORIS.SELO PLEMETINA.

Pika 9 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës për vendosjen në debat publik të Draft-Planit Komunal për Integritet për periudhën 2027-2030.

Fitore Hashani – Po kryesues, e kemi sqaru dhe e kemi parë edhe materialin, e falenderojmë Kryetarin për këto shkresa, ndërsa kisha dilemë rreth Komisionit kush do të pranoj në këtë Plan të integritetit. E dimë që është rutinë për çdo 3 vite që bëhet megjithatë, mungonte emri i kordinatorit dhe vendimi i Komisionit, në mënyrë që nëse kemi diçka ta dërgojmë me email për këtë Plan për plotësim ndryshim, ose në debate publike, të dimë kujt me iu drejtuar.

Kryesuesi – Nëse veç nuk e kemi këtë informatë këtu ne do të iu informojë në afat sa më të shpejtë lidhur me përbërjen e Komisionit.
Ariana Grajqevci – Po Komisioni është dhe brenda këtyre ditëve mund të ia bashkangjesim dokumentit në fjalë.
Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit të Komunës me 18 vota për, dhe 2 vota abstenim morën Vendim për dhënien në debat publik të Draft-Planit Komunal për Integritet për periudhën 2027-2030.
Pika 10 e rendit të ditës
Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e Projekt-Propozimit të drejtorit të DPUKP-së, për fillimin e procedurave për hartimin e Planit rregullues të hollësishëm.
Fjolla Nasufi – E mbështesim fillimin e procedurave për këtë Plan sepse Obiliqit, i duhet një planifikim i mirëfilltë dhe zhvillim i organizuar.
Fitore Hashani – Tash, viteve të fundit i rregulluam edhe Planin zhvillimor komunal dhe hartat zonale, mbi të cilat edhe do të bazohet ky Plan Rregullues i hollësishëm. Ndoshta, disa sqarime më të detajuara do të ishte e nevojshme prej drejtorit për shkak edhe të korrektësisë së qytetarëve, por sidomos zonës në qendër meqenëse do të preken një mori parcelash, ashtu siç e kemi marrë edhe në raport. Do të doja të di nga erdhi kërkesa, cilat janë specifikat që duhet të ballafaqohemi dhe sa ka planifikim të debateve me qytetarët ose me gjithë zonën e prekur, në mënyrë që të bëjmë planifikimet tona të jemi pjesëmarrës në këto debate, që të japim kontributin tonë.
Gazmend Krasniqi – Sa i përket Planit ne e kemi pasë shumë të nevojshme pasi që në kohën e fundit e përmende edhe vetë që është bërë harta zonale, por edhe aty ka mungesa që është drejtuar në një formë që më shumë kisha me thënë personale se në favor të qytetit. Prandaj, me këtë Plan detaj të hollësishëm do të merren parasysh të gjitha duke u nisë prej infrastrukturës, mobilitetit, shfrytëzimit të pronës, parametrave urbanistik, banimit, afarizmit, zhvillimit të qytetit, të jetë më e kontrolluar dhe të punohet taman për një qytet. Ne duhet të dimë se çfarë rrugë kemi me pasë brenda qytetit dhe harta zonale normal nuk është që i parashehë këto pjesë, të dijmë se çfarë komunikacioni do të kemi brenda qytetit, të dijmë sa parqe duhet të jenë brenda qytetit. Po ashtu, duhet të dimë saktësisht se ku janë institucionet brenda qytetit tonë dhe ky është qëllimi dhe për këtë arsye e kemi bërë fillimin e kërkesës, që të kemi një Plan detaj të hollësishëm brenda qytetit të Obiliqit.
Fitore Hashani – Vetëm deshta pak përmirësim, nuk do të mund të lejoja këtu, se është punuar Plani ose hartat profesionale personale sepse e dimë se këto i miraton Ministria e Planifikimit Hapësinor. Këto, punohen me kompanitë profesionale po ashtu, dhe detajohen me qytetarë dhe me të gjitha Komisionet. Unë nuk dua të shkaktoj polemika të ndryshme vetëm sa për sqarim sepse e dimë se tha më heret kryesuesi që kemi institucione dhe unë i respektoj këto institucione të vendit tim.
Gazmend Krasniqi – Sa i përket kësaj e dimë të gjithë se qysh janë drejtuar hartat zonale, nuk mundet qyteti i Obiliqit, në një zonë në qendër të ketë koeficientin më të ulët të ndërtimit, ndërsa në një zonë ku është më afër elektranave të ketë një ndërtim më të lartë. Po ashtu, nuk mundet që pronat e biznesit parqet industriale vetëm të dallohen me disa parcela ku kanë qenë interesat e ndryshme të bizneseve ndërsa, të tjerat të mbeten jashtë. Kjo është kur thashë janë orientuar nga njerëz brenda këtu, që ky planifikim është bërë. Ndërsa, te pjesa e kompanive, e Ministrive ne e dimë krejtë se qysh shkojnë këto, kur nuk ka ndonjë parametër diçka, e kalojnë atë dhe nuk është ndonjëfarë problemi për ata.
Abdyrrahman Krasniqi – Drejtor, unë kisha pasë një pyetje për ju, por ndoshta edhe për Kryetarin pse veç zona në qendër atëherë, pse po i përjashtojmë edhe zonat tjera edhe fshatrat. Ndoshta, kishte me qenë mirë për një rishikim total apo nuk është mundësia aktuale tash.
Gazmend Krasniqi – Fillimisht kemi filluar prej zonës në qendër pasi që këto merren detajisht dhe është një punë bukur e madhe voluminoze, që bëhet brenda këtij Plani. Në momentin kur përfundojmë me zonën në qendër atëherë, kemi me filluar edhe me zonat tjera.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit të Komunës me 18 vota për, dhe 2 vota abstenim morën Vendim për Miratimin e Propozimit për fillimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për territorin/zonën Qendër të Komunës së Obiliqit.

Pika 11 e rendit të ditës

Kryesuesi – E kemi pikën e cila në fillim të seancës është shtuar në rend dite dhe me këtë rast e ftoj znj. Albanë Shillova Shalaku, të qartësoj propozimin dhe të bëjë propozimet e duhura.

Albanë Shillova Shalaku –Propozimi ynë është formimi i një Komisioni ad hoc për verifikimin dhe mbikqyrjen e dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës së Obiliqit. Kërkesa jonë është e bazuar në nenin 51 paragrafi 2 të Ligjit nr.0/L-040 të LVL-së, ku neni 51.2 thotë Kuvendi i Komunës themelon Komitetet e tjera, për të cilat konsideron se janë të nevojshme për kryerjen e përgjegjësive të tyre. Gjithashtu, neni 13 pika 1 thotë;Kuvendi i Komunës, varësisht nga nevoja për kryerjen e përgjegjësive në sektorë të caktuar mund të themeloj këto Komitete me vendim më urgjent.

Kryesuesi – Znj.Shalaku, a ka mundësi me na tregu edhe për përbërjen e Komisionit.

Albanë Shillova Shalaku – Përbërja e Komisionit sipas ligjeve dhe Rregulloreve në fuqi është se duhet të jenë 4 anëtarë të Kuvendit dhe 1 ekspertë i jashtëm. Ne propozojmë znj.Fjolla Nasufi dhe z.Burim Ismaili.

Kryetari – Unë e përgëzoj shumë këtë nismë sepse kjo nismë është shumë e rëndësishme për zhvillimin e Komunës tonë. Ne e dimë se prej vitit 2000 e tutje, janë dhënë toka në menaxhim nga Komuna e Obiliqit dhe unë i falenderoj shumë ata që kanë investuar, i falenderoj edhe ata që i kanë dhënë këto prona.Mirëpo sido që të jetë e kemi obligim ligjor që të ulemi të bëjmë një prerje të përhershme të atyre, që kanë punuar dhe të atyre që nuk kanë punuar. Kjo, nuk ka diçka tendencë përveç se ne po e zbatojmë ligjin dhe iu kisha lutë të gjithë anëtarëve të Kuvendit, të jeni pjesë e këtij Komisioni, në mënyrë që ta jepni kontributin tuaj sepse pasuria publike sot na takon neve si qytetarë, por nesër do ti takoj gjeneratës së ardhshme fëmijëve tonë e nipërve tonë. Prandaj, ju lus të gjithë juve që ta japim kontributin. Unë kurrë nuk dua të supozoj se dikush dikujt ia ka dhënë pronën për interesa personale, por interesi gjithmonë i Komunës ka qenë interesi i zhvillimit të Komunës. Mirëpo, ka keqpërdorues që ato prona i kanë keqpërdorë, kështu që ne duhet ato ti verifikojmë. Ju si Kuvend, duhet ti verifikoni këto prona, të na sjellni raportin e të gjeturave, pastaj unë si Kryetar dhe drejtori i DPUKP-së, do të vazhdojmë mëtutje. Po ashtu, edhe ne do ta sjellim raportin në Kuvend dhe të gjithë së bashku do të vendosim mëtutje. Ju duhet ta keni parasysh se po flasim për pronën komunale, që iu është dhënë në shfrytëzim për 99 vite, personave të cilët shumica prej tyre ato prona i kanë përdorë mirë, por ka edhe prej tyre që i kanë keqpërdorë. Prandaj, kërkoj nga ju mbështetje në këtë pikë sepse prona nuk është as e Ekzekutivit, por është e gjithë qytetarëve të Komunës së Obiliqit.

Fidan Ahmeti – Edhe unë pajtohem me Kryetarin në këtë pikë sepse vërtetë, jemi të interesuar të gjithë për me u ndërtuar dhe zhvilluar qyteti ynë, që më së shumti zhvillohet me biznese siç e dimë të gjithë, por edhe jam shumë këmbëngulës me i'u marrë atyre, bizneset që nuk kanë investuar fare. Nëse, nuk gaboj janë 3 faza; faza e parë është aplikimi për leje që Drejtoria këto i din më mirë, mirëpo nëse asnjërën prej këtyre fazave nuk e ka respektuar atëherë, pse ne duhet atij me ia lënë tokën në shfrytëzim kur ia jepë dikujt që e shfrytëzon. Është mirë Komisioni që caktohet disa prej kritereve që duhet me i pasë banorët e Komunës së Obiliqit, me qenë punëtorë realisht edhe kjo është një prej kritereve që duhet me përcjellë se a janë duke e marrë apo jo. Unë për vete jam i interesuar me dhënë kontribut te kjo pjesë dhe nëse, kolegët tjerë nuk janë të interesuar të jenë në Komision, unë jam direkt që shkoj.

Abdyrrahman Krasniqi – Fillimisht e përgëzoj deputetin për këtë iniciativë që mendoj se është iniciativë e qëlluar, ashtu siç e thanë edhe parafolësit prona është e shenjtë dhe ne bashkarisht duhet me i kontrollue, ose me i pa ato projekte qysh janë zhvilluar. Për këtë temë nëse, ka hapësirë e propozoj z.Labinot Mirena të jetë pjesë e Komisionit.

Labinot Mirena – E falenderoj kolegun z.Abdyrrahman, por unë e kam një propozim pak më ndryshe, që të jetë Komisioni prej 4 anëtarëve, LVV-ja veç i propozoi 2 anëtarë prej tyre dhe unë kisha pasë dëshirë me i propozu edhe 2 që kanë qëndru stoik partive të tyre z.Abdyrrahman Krasniqi LDK dhe znj.Dorentina Mustafa AAK.

Fjolla Nasufi – Nëse, po ndahemi kështu atëherë një anëtar me lënë të LVV-së, një prej këtyre të pavarur një të AAK-së dhe një të LDK-së.
Linda Bekteshi – Pasi që jemi në këtë temë duke diskutuar, siç e dini zhvillimet e fundit që kanë ndodhë kërkoj me na dhënë 15' pauzë për arsye që grupi i LDK-së, me zgjedhë edhe shefin e grupit.
Kryetari – Më fal, unë jam kurioz me ditë kush është në LDK, më falni por në facebook e kam parë një postim ku ishKryetari i Komunës dhe Kryetari i LDK-së, së bashku me juve të gjithëve ka dhënë dorëheqje prej LDK-së. Prandaj, nuk kam parë regim apo një qëndrim tuajin për t' u distancuar prej atij postimi të z.Gashi. Ne jemi përfaqësues politik prandaj, kishte me qenë mirë me dalë dhe me dhënë një qëndrim tuajin se çka do të thotë ai postim i ishKryetarit të Komunës, i ishKryetarit tashmë të LDK-së, a jeni pro, a jeni kundër apo qysh jeni.
Linda Bekteshi – Kryetar, po e sqaroj se unë jam LDK, z.Muhamet Preniqi është LDK dhe z.Bajram Hashani është LDK, ndërsa z.Abdyrrahman Krasniqi dhe z.Labinot Mirena janë të përjashtuar nga LDK-ja, qe 10 muaj, me vendim të Kryesisë nën 1. Nën 2; Vlora Mjekiqi Kabashi, e keni parë publikisht se nuk është më pjesë e LDK-së, ka dhënë dorëheqje prej të gjitha strukturave. Andaj, unë kërkoj nga kryesuesi sipas Rregullores të na jepë 15' pushim në mënyrë që ne ta formojmë grupin parlamentar të LDK-së. Besoj se e more vesh Kryetar kush është LDK.
Abdyrrahman Krasniqi – Kryesues, edhe unë kërkoj sqarim qysh e tha dhe kërkoj Kryetari sepse fundja ne jemi me punuar në interes të qytetarëve. Mirëpo, këtyre a iu kanë rënë dritat 24 orë dhe le të vendosin pas kësaj mbledhje se ku kanë me qenë dhe në mbledhjen e ardhshme, le të vijnë me një vendim sepse këta as vetë nuk e dinë se ku janë. Realisht këta, nuk e dinë se unë kam biseduar me disa prej tyre edhe para 2 netëve, që janë takuar në kafe, ia kanë dhënë njeriut besën se kanë me përkrahë iniciativën te kafja e djalit të Hysenit, ka qenë znj.Linda, z.Muhamet dhe z.Bajram aty, dhe këta ia kanë kërkuar besën se a më përkrahni për me qenë kandidat i iniciativës. Ky është degradim i një partie, ose një institucioni.
Bajram Hashani – Ndërpreja fjalën se është duke folë të pavërteta, shumë të pavërteta.
Linda Bekteshi – Nuk e ka të drejtën e fjalës sepse ne nuk jemi në zyre të partisë, por jemi në Kuvend. Për çështje partiake flasim jashtë, ndërsa këtu jemi duke folë në Kuvend.
Abdyrrahman Krasniqi – Është niveli i lartë i servilizmit një njeri me qenë kandidat i 3 partive politike. Ne kemi mandat me i përfaqësue qytetarët dhe unë nuk përmenda asnjë emër, nuk mund të thirren në emër të një partie që kanë dhënë dorëheqje, ju lutem kjo është nonsens.
Kryesuesi – Fillimisht iu kisha lutë me respektuar rendin e ditës dhe kur kalojmë në pikën të ndryshme mund të bisedojmë sa të doni. Ne po shkojmë sipas pikës të rendit të ditës që ishim, e patëm një kërkesë shumë të domosdoshme, shumë konstruktive dhe të nevojshme për qytetarët e Obiliqit, tani po kaloni në problemet që kanë qenë në mes të partive. Ju rikujtoj se nuk mundeni me quajtë dikend më ndryshe se sa që ka dalë prej zgjedhjeve. Është dëshirë e secilit person se në cilin subjekt e ndjen veten, megjithatë dikend mund ta përjashtosh prej strukturave të brendshme partiake.
Bajram Hashani – Të kisha lutë kryesues, vazhdo me rendin e ditës se kemi edhe ne me thënë shumë gjëra, bile kush është z.Abdyrrahman me na mbajtë këtu, ligjërata askushi nuk është hiç.
Labinot Mirena – Kryetar, ashtu qysh po thua ti është e vërtetë dhe unë e kam pasë gjithmonë një mendim pak më ndryshe për me mbrojtë interesin e qytetarëve, e jo interesin personal të njerëzve, të cilët sot e japin premtimin dhe nesër tërhiqen. Në mbledhjen e kaluar unë iu kam kërkuar falje në emër të LDK-së, që iu kemi lënë shumë telashe dhe ju kërkoj edhe sot. Këta, veç LDK nuk janë as nuk kanë qenë kurrë dhe unë emrin e kam më njohin të gjithë këtu, por në emrin e LDK-së, emrin mos ma përmendni kurrë se unë asnjë emër nuk e përmendi kurrë, a jam a nuk jam më së miri e thojnë qytetarët qysh e kanë thënë gjithë me vota. Këtu, për shembull asnjë nuk është në LDK sepse nga 20 parti i kanë ndërru.
Kryesuesi – Grupi pralamentar konsiderohet grup me 3 anëtarë dhe ju veç jeni gup parlamentar nëse, e konsideroni si të tillë.
Kryetari – Znj.Linda, unë vetëm kërkova se a distancohesh prej postimit të z.Xhafer Gashi dhe ju mund të thoni distancohem nga postimi i z.Xhafer Gashi, sepse na ka gënjye na ka thënë 6 asambleistë aty dhe dalin prej LDK-së, që nuk është korrekte me lu me integritetin e profesorit të z.Bajram Hashani. Ne jemi përfaqësues politik të qytetarëve, prononcimet tona duhet me qenë publike dhe nëse, dikush ka manipuluar

me juve, duhet me dalë dhe me thënë distancohem publikisht prek atij postimi sepse nuk dorëhiqem nga LDK-ja, kaq.
Abdyrrahman Krasniqi – Unë nuk mendoj se është koha për pauzë se këta, nuk kanë të drejtë me u thirrë më në emër të LDK-së, këta kanë dhënë dorëheqje publikisht dhe kjo nuk mund të formoj grup të LDK-së.
Kryesuesi – Shkojmë 15' në pauzë pastaj, e vazhdojmë mbledhjen.
Pas pauzës prej 15' mbledhja vazhdon.
Kryesuesi – Vazhdojmë me pikën e 11 të rendit të ditës, e kemi formimin e Komisionit ad hoc për verifikimin e dhënies së pronave të paluajtshme të Komunës së Obiliqit dhe menaxhimit të tyre. Propozimet u dhanë më shumë se që duhej dhe nga LVV-ja, ishte propozimi për znj.Fjolla Nasufi dhe z.Burim Ismaili, z.Fidan Ahmeti u vetëpropozua, Pastaj ishte propozimi për z.Labinot Mirena i cili e propozoi z.Abdyrrahman Krasniqin dhe ishte Dorentina Mustafa si propozim. Ashtu siç e tha iniciatorja e kësaj pike ligjërisht Komitetet e këtij niveli duhet të jenë prej 5 anëtarëve, në përfshirjen e të cilëve duhet të jetë edhe një ekspertë i jashtëm. Grupi që kërkoi pauzë 15' a keni ndonjë propozim.
Linda Bekteshi – Propozon z.Muhamet Preniqi, për anëtar të Komisionit.
Kryesuesi - Për hir të opinionit është mirë saktësisht me kuptue se çka përfaqësoni sepse është bërë kohën e fundit pak problem dhe në emrin tuaj, që është bërë një postim ju keni dhënë dorëheqje. Prandaj është mirë me komentue si pikë se a jeni vërtetë që ti evidentojmë saktësisht si të tilla. Do të thotë ju jeni LDK dhe a distancoheni prej postimit që është bërë në emrin tuaj.
Abdyrrahman Krasniqi – Kryesues, dua të them se këta, nuk mund të jenë LDK pa u distancuar publikisht sepse publikisht kanë dhënë dorëheqje dhe publikisht duhet me deklaru se nuk pajtohen me atë udhëheqje, kanë ndryshuar mendjen përndryshe, këta nuk mund të propozojnë në emër të LDK-së, ose le ti drejtohen me një shkresë partisë se a i lejon me u rikthy. Nuk mundesh sot me dhënë dorëheqje e nesër me u rikthy në parti edhe para 2 netëve, prapë me ishKryetarin që ka dhënë dorëheqje ia kanë konfirmue se do të jenë me iniciativën qytetare, që kanë me kandidu për Kryetar të Komunës së Obiliqit, ne këto gjëra i dimë.
Kryesuesi – Seanca e Kuvendit, është publike dhe grupi prej 3 anëtarëve e thanë se distancohen nga ai postim.
